



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4/41  
Datë: 21/11/2025

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, bazuar në dispozitat e nenit 14 të Statutit të UP-së, si dhe në dispozitat e nenit 19, pika 8, nenit 28, pika 1, nënpika 1.2, të Rregullores së punës nr. 280 të datës 13.2.2025, në mbledhjen e mbajtur më 19.11.2025, mori vendim të shpallë:

### KONKURS

**Për ndarjen e bursave universitare për studentët e studimeve master me programin njëvjeçar për vitin akademik 2024/25 për Fakultetin e Arteve**

#### I. Kushtet e përgjithshme

1. Bursat universitare ndahen për studentët e nivelit të studimeve master, shuma vjetore e bursës është në vlerë: 700 euro.
2. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët që i plotësojnë këto kushte:
  - 2.1. Të jenë studentë të rregullt të Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës;
  - 2.2. Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
  - 2.3. T'i kenë të regjistruar të dy semestrat e vitit akademik 2024/25;
  - 2.4. T'i kenë dhënë të gjitha provimet e parapara për vitin përkatës të studimeve në afatin e shtatorit të vitit akademik 2024/25 dhe t'i kenë të përfunduara të gjitha provimet në afatin e shtatorit, sipas programit të studimeve;
  - 2.5. Të kenë notë mesatare të përgjithshme jo më të ulët se 9.00 (nëntë pikë zero).
3. Studentëve që nuk i plotësojnë kriteret e mësipërme, shërbimi i studentëve në njësinë akademike përkatëse nuk do t'ua verifikojë në SEMS, fletëparaqitjen e cila ua mundëson aplikimin për bursë.

#### II. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët që i plotësojnë kushtet nga pika I e këtij konkursi, aplikimin duhet ta bëjnë përmes platformës elektronike SEMS, në linkun: [sems.uni-pr.edu](https://sems.uni-pr.edu)
2. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:
  - 2.1. Kërkesa për aplikim (Fletë aplikacioni), e cila shkarkohet pas aplikimit online përmes SEMS -it.
3. Studenti është i obliguar që fletë aplikacionin ta printojë dhe ta dorëzojë në shërbimin e studentëve të fakultetit përkatës, si dëshmi që ka aplikuar brenda afatit të paraparë të konkursit.
4. Fakulteti i Arteve obligohet të përgatis listat e studentëve sipas kriterëve të përcaktuara në këtë konkurs, për miratim nga Këshilli Drejtues i UP-së.



5. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave e bart dekani i njësisë akademike.
6. Bursat universitare për vitin akademik 2024/25 ndahen për rezultatet e arritura në vitin akademik 2024/25,
7. Nëse gjatë aplikimit paraqiten probleme eventuale teknike, studentët duhet të paraqesin kërkesë për ndihmë në SEMS, te pjesa Kërkesa/Ankesa duke përshkruar problemin që u shfaqet.

### III. Afati i aplikimit

1. Aplikimi në linkun [sems.uni-pr.edu](https://sems.uni-pr.edu) hapet nga **data 21.11.2025 në ora 10:00** dhe përfundon me datë **26.11.2025, në ora 16:00**

### IV. Afati i ankesave.

1. Studentët që konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e përfituesve, kanë të drejtë ankesë brenda **48 orëve** pas ditës së publikimit të listave.
2. Ankesat dorëzohen në **zyrën e arkivit të UP-së (nr. 18)**, në ndërtesën e Rektoratit të UP-së.
3. Ankesat e dorëzuara pas afatit **nuk do të merren në shqyrtim.**

### V. Publikimi

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve dhe faqet zyrtare të Fakultetit të arteve, si dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Prishtinës: [www.uni-pr.edu](https://www.uni-pr.edu).



